



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr. 96/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arnis Dumani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësve N.Sh.P. “Fauna Jonë” me seli në Kamenicë, Krenidel, p.nr., përfaqësuar nga R.SH. nga Kamenica dhe “Agrounion” Sh.P.K., me seli në Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, përfaqësuar nga R.SH., kundër të paditurit Kuvendi Komunal Kamenicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.H., për shkak të anulimit të Vendimit nr. 29495 i datës 19.09.2018 dhe Vendimit nr. 30618 të datës 02.09.2014, pas shqyrtimit kryesor publik në rigjykim të mbajtur me datë 27.07.2023, në prezencë përfaqësuesve të autorizuar të palëve, me datë 31.07.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadija e paditësve N.Sh.P. “Fauna Jonë” dhe “Agrounion” Sh.P.K., ANULOHEN si të kundërligjshëm Vendimi nr. 29495 i datës 19.09.2018 i nxjerrë nga komisioni për shqyrtimin e ankesave pranë të paditurit Komuna e Kamenicës dhe Vendimi nr. 30618 i datës 02.09.2014 i Kuvendit Komunal Kamenicë.
- II. Ky Aktgjykim i zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter detyrues.
- III. Lidhur me kërkesën për kompensimin e dëmit, paditësi udhëzohet në procedurë kontestimore.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësit N.Sh.P. “Fauna Jonë” dhe “Agrounioni” Sh.P.K me datë 05.10.2018 kanë parashtruar padi kundër të paditurit Kuvendi Komunal Kamenicë, me kërkesë për anulimin e vendimit nr. 29495 të datës 19.09.2018 si i kundërligjshëm si dhe ka kërkuar që vendgjahishta në Kamenicë ti jepet në menaxhim paditësve pasi që plotësojnë të gjitha kriteret ligjore si dhe kompensimin e shpenzimet procedurale. Tutje paditësi në padi ka theksuar e kundërshton në tërësi vendimin e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave të Procedurës për Dhënien e Pronës së Paluajtshme

të Komunës së Kamenicës nr.29495 të datës 19.09.2018 për shkak se është shkelur e drejta dhe interesi i drejtpërdrejt dhe i bazuar në ligj, sepse ky vendim bie në kundërshtim të plotë me vetveten me gjendjen faktike, me Ligjin nr.04/L-144 të datës 22.11.2012 dhe me vërejtjet e dhëna në Aktgjykimin A.nr. 2090/2014 të datës 16.11.2017 të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative si dhe Rregullores për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës QKR.nr.23/2013 dhe Ligji për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës nr.04/L-144. Në seancën e datës 07.06.2023 përfaqësuesi i paditësit ka deklaruar se trajtimi i kësaj procedure që nga fillimi kur është dorëzuar lënda me 21.05.2014, është bërë shkelja e parë, është hap zarfi vetëm nga një person, F.J., pa prezencën e Komisionit për Hapjen e Zarfeve, ndërsa i njëjti nuk ka qenë anëtar i komisionit për hapjen e ofertave, pastaj nuk është njoftuar as me shkrim as me gojë për arsyen e eliminimit nga kjo procedurë, kjo krejt ka qenë qëllimshëm që të humb e drejta e ankesës. Ka shtuar se e ka kuptuar se kush është fitues nga ky aktivitet në bazë të shpalljes publike që e ka bërë e paditura në komunë me shkresën me nr.653-14-002 me datë 28.06.2014 e cila ekziston në lëndë. Pra në këtë shkresë ka qenë e shkruar vetëm kush e ka fituar, në të shkruan “dhënia me qira të vendgjahishtes në Komunën e Kamenicës”, por nuk shënojnë arsyet përse janë eliminuar paditësit të cilët kanë ofertuar si konzorcium. Ka shtuar se shkeljet kanë vazhduar me hapjen e zarfit numër 2 i cili është kopje dhe është hap në komunë dhe pa prezencën e ndonjë personi tjetër, kjo pasi që i padituri ka eliminuar paditësit si konzorcium nga procedura me pretendimin se mungon deklarata nën betim e anëtarit të Konzorciumit, përkatësisht deklarata e “Agrounion” Sh.P.K.,. Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i paditësit deklaroi se mbetet në tërësi pranë padisë dhe deklarimeve nga seancat e kaluara, dhe parashtrimeve të bëra në këtë çështje që nga paraqitja e padisë, tutje thekson se nga provat të cilët gjykata e obliguar të paditurin që ti dorëzoj, nuk është zarfi i dytë dhe as procesverbali i hapjes së zarfit dhe ka shtuar se me këtë vërtetohen pretendimet e paditësit se zarfi i mbyllur që është dorëzuar në kopje është hapur pa ndonjë procedurë të rregullt në mënyrë që ti pamundësohet paditësit vërtetimi i pretendimeve të tij, andaj gjykatës i ka propozuar që të vendosë sipas propozimit në padi lidhur me këtë çështje.

I padituri në përgjigjen në padi të datës 15.04.2021 e kontestoi në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve, pasi që konsideron se e njëjta nuk gjen mbështetje në asnjë bazë ligjore dhe se vendimi i atakuar është nxjerr në përputhje me dispozitat e ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitat e ligjit 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. I padituri konsideron se

komisioni ka nxjerr vendim të drejtë dhe të ligjshëm, kjo ngase bazuar në dokumentet në të cilat është bazuar vendimi i atakuar rezulton që paditësi nuk i ka plotësuar të gjitha kushtet të cilat janë kërkuar në dosjen e ofertës, kjo ngase të njëjtave iu ka munguar deklarata nën betim, kusht ky që ka qenë detyrues në mënyrë që oferta të vlerësohet e plotë dhe e përgjegjshme. I padituri kundërshton pretendimet e paditësit në lidhje me largimin e dokumentit “deklaratë nën betim” nga dosja nga anëtarët e komisionit, kjo ngase bazuar në procesverbalin e seancës së datës 19.09.2014, vërtetohet fakti se është shikuar edhe kopja edhe origjinali i aplikimit të dërguar dhe ka rezultuar që as në kopje e as në origjinalin e dosjes nuk ka qenë e dorëzuar deklarata nën betim e operatorit ekonomik “Agrounioni” Sh.P.K. Në seancën e datës 06.07.2023 përfaqësuesi i autorizuar i paditësit deklaroi se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi duke e kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve për shkak se konsideron se e njëjta nuk gjen mbështetje në asnjë bazë ligjore dhe vendimi i atakuar është nxjerr në përputhje me dispozitat e LPPA-së dhe ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme. Me rastin e rishqyrtimit dhe rivendosjes Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave ka vendosur që ta refuzoj ankesën e palës paditëse për shkak se të njëjtit kanë ardhur në përfundim që oferta e paditësve ka qenë e papërgjegjshme, kjo ngase të njëjtit përmes procesverbalit të datës 19.09.2014 është shikuar kopja dhe origjinali i aplikimit dhe është vërejtur se me rastin e ofertimit ka munguar deklarata nën betim e OE Agrounioni ShPK, andaj kanë kërkuar nga gjykata që padinë e paditësve ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa të mbetet në fuqi vendimi nr.29495 i datës 19.09.2018.

Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në rigjykim, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendim nr. 29495 i datës 19.09.2019, Procesverbal i Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave datë 09.07.2019, Kontratë për qiranë nr. 30684 i datës 03.09.2014, Njoftim për dhënie të Kontratës datës 28.08.2014, Procesverbal i hapjes së tenderit i datës 21.05.2014, Procesverbal i seancës dëgjimore 19.04.2014, Aktgjykim A.nr 2090/14 i datës 16.11.2017 i GJTHP- Departamenti për Çështje Administrative, Deklaratë pjesëmarrjeje i datës 21.05.2014 e nënshkruar nga R.SH. – Agrounion Sh.P.K. dhe Deklaratë nën betim, Deklaratë pjesëmarrjeje e datës 21.05.2014 e nënshkruar nga R.SH. – NSHP Fauna Jonë dhe Deklaratë nën betim, Plani i veprimit, Vërtetim nr.101/12 datë 09.11.2012, Kërkesë për Rivendosjen e Çështjes datës 04.06.2018, Kërkesë për nxjerrjen e aktit të ri administrativ datë 07.03.2018, Kërkesë për nxjerrjen e aktit të ri administrativ 09.01.2018, Kërkesë e datës 05.04.2018, Propozim për shkëputjen e parakohshme të kontratës datë 01.12.2018, Leje për gjueti nr 00856,

00923,00971,00998,01027,01066,00454, 00433, Vendim për mbylljen e sezonit të gjuetisë 2016/2017 i datës 15.12.2016, Procesverbal i seancës dëgjimore 19.09.2014, Raporti i punës nr.41177 i datës 19.12.2014, Raporti i vlerësimit të tenderëve i datës 23.05.2014, Caktimi i Komisionit për hapjen e ofertave nr.42 datë 21.05.2014.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 37 par.3 dhe 44 të LKA-së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, pretendimeve të palët ndërgjyqëse në seancë, thënieve në padi si dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresave tjera të lëndës gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Gjykata fillimisht konstaton se lidhur me këtë çështje Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin A.nr. 2090/2014 të datës 16.11.2017 ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve “Fauna Jonë” dhe “Agrounion” Sh.p.k., ashtu që ka anuluar vendimin e të paditurit Komuna e Kamenicës, me nr. prot. 01 nr. 32793 të datës 22.09.2014 si dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek i padituri.

I padituri Kuvendi Komunal Kamenicë - Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Kamenicës në rishqyrtim dhe rivendosje me Vendimin nr. 29495 të datës 19.09.2018, ka refuzuar të pabazuar ankesën e paditësve dhe ka vërtetuar vendimin e Kuvendit Komunal nr.30618 të datës 02.09.2014 për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga komisioni vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër N.P.Sh. “Qendrës Kopshtare” nga Koretini.

Kundër këtij vendimi, paditësi ka ushtruar padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, e cila me Aktgjykimin A.nr. 2405/2018 të datës 05.10.2021 ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve “Fauna Jonë” dhe “Agrounion” Sh.p.k., dhe ka anuluar vendimin nr. 29495 të datës 19.09.2018.

Duke vepruar sipas ankesës së të paditurit, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Çështje Administrative, me Aktvendimin AA.nr. 26/2022 të datës 20.10.2022 kanë aprovuar ankesën e të paditurit Kuvendi Komunal Kamenicë ndërsa Aktgjykimi A.nr. 2405/2018 i datës 05.10.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative A.nr. 2405/2018 të datës 05.10.2021 është prishur dhe lënda është kthyer në rigjykim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 32 të Rregullores QRK nr. 23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe

Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës, i cili përcakton se: *“Në rast të kontestit eventual në mes të palëve kontraktuese, atëherë kontesti zgjidhet në procedurë gjyqësore nga gjykata kompetente”* lidhur me nenin 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton se: *“Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative.”*

Gjykata i vlerësoi të bazuara pretendimet e paditësit sepse nga provat e administruara gjykata konstatoi se i padituri në procedurë administrative nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe i padituri në këtë procedurë të konfliktit administrativ nuk i ka dorëzuar shkresat e lëndët për të vërtetuar pretendimet e paraqitura në përgjigje në padi dhe për të mbështetur arsyetimin e paraqitur në vendimin kontestues.

Gjykata, nga provat e administruara në këtë çështje të konfliktit administrativ ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Nga Kontrata për qiranë lidhur me menaxhimin e vendgjuetisë në komunën e Kamenicës nr.30684 i datës 03.09.2014, gjykata konstatoi se i padituri ka lidhur kontratë me NPSH “Qendra Kopshtare” për dhënien me qira të vendgjahishtës në Kamenicë.

Nga Njoftimi për dhënie të Kontratës i datës 28.08.2014, gjykata ka konstatuar se i padituri me datë 28.08.2014 ka publikuar njoftimin se dhënia me qira e vengjahishtës në Kamenicë është bërë për NPSH “Qendra Kopshtare” i cili ka ofertuar me çmimin prej 44,444,44 euro për 10 vite.

Nga Procesverbali i hapjes së tenderit i datës 21.05.2014, gjykata ka konstatuar se Komisioni për hapjen e ofertave ka konstatuar se në aktivitetin “Dhënia me Qera e Vendgjahishtës – Kamenicë” kanë ofertuar 4 operatorë ekonomik: NTP “Rendimenti” me çmim 24,000.00€; “Fair Hunt” Sh.p.k. me çmim 60,100.00€; “Fauna Jonë” me çmim 45,850.00€ dhe “Qendra Kopshtare” me çmim 44,444.44€.

Nga Procesverbali i seancës dëgjimore 19.04.2014, gjykata ka konstatuar se Komisioni i Ankesave, gjatë shqyrtimit të ankesës së konzorciumit “Fauna Jonë” dhe “Agronunion” Sh.p.k. ka ftuar ankuesit Kreshnik Sadiku nga OE “Fair Hunt” Sh.p.k. dhe R.SH. nga OE “Fauna Jonë” dhe ju ka dhënë mundësinë e deklarimit të pretendimeve ankimore lidhur me procedurën e dhënies me qera e vendgjahishtës në Kamenicë.

Nga Deklaratë pjesëmarrjeje e datës 21.05.2014 e nënshkruar nga R.SH. – Agrounion Sh.P.K., dhe Deklaratë nën betim, Deklaratë pjesëmarrjeje e datës 21.05.2014 e nënshkruar nga R.SH. – NSHP Fauna Jonë dhe Deklaratë nën betim, gjykata ka konstatuar se paditësit si prova kanë dorëzuar Deklaratat nën betim për OE NSHP Fauna Jonë dhe OE “Agrounion” e të cilat pretendon se kanë qenë pjesë e ofertës së dorëzuar nga paditësi lidhur me thirrjen për dhënien me qera e vendgjahishtës në Kamenicë

Nga Vërtetim nr.101/12 datë 09.11.2012, gjykata ka konstatuar se Federata e Gjahtarëve të Kosovës ka konfirmuar se R.SH. është anëtarë i Kryesisë së Shoqatës së Gjahtarëve të Kosovës që 4 vite.

Nga Kërkesa për nxjerrjen e aktit të ri administrativ datë 09.01.2018, Kërkesa për nxjerrjen e aktit të ri administrativ datë 07.03.2018 dhe Kërkesë e datës 05.04.2018, gjykata ka konstatuar se paditësit i janë drejtuar të paditurit me kërkesë për nxjerrjen e aktit të ri administrativ pasi që Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin A.nr. 2090/14 të datës 16.11.2017 kishte anuluar vendimin e të paditurit me të cilin ishte refuzuar ankesa dhe çështjen e kishte kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje.

Nga Propozim për shkëputjen e parakohshme të kontratës datë 01.12.2018, gjykata ka konstatuar se paditësit kanë kërkuar nga i padituri që të bëhet shkëputja e parakohshme e kontratës pasi që tashmë gjykata ka konstatuar se dhënia në shfrytëzim e vengjahishtës në Kamenicë është bërë në mënyrë të kundërligjshme dhe se është lejuar gjuetia jashtë sezonës së caktuar për gjueti.

Nga Lejet për gjueti nr. 00856, 00923, 00971, 00998, 01027, 01066, 00454 dhe 00433, gjykata ka konstatuar se “Qendra Kopshtare” ka lëshuar disa leje për gjueti për periudhën kohore 24-25.12.2016, 31.12.2016 – 01.01.2017, 7-8.01.2017, 22.01.2017, 26.01.2017, 31.01.2017.

Nga Vendimi për mbylljen e sezonit të gjuetisë 2016/2017 i datës 15.12.2016, gjykata konstatoi se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka vendosur që me datë 26.12.2016 të mbyllet sezoni i gjuetisë për vitin 2016 – 2017 pasi që është konstatuar zvogëlim i fondit të kafshëve të egra si pasojë e gjuetisë ilegale, degradim të habitateve natyrore dhe menaxhim jo efikas të faunës së egër.

Nga Raporti i punës nr.41177 i datës 19.12.2014, gjykata ka konstatuar se Komisioni Komunal për vlerësimin e ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Kamenicës në shfrytëzim takimin e parë për vlerësimin e ofertave e ka mbajtur me datë 21.05.2014, ndërsa

në takimin e dytë të mbajtur me datë 23.05.2014 kanë vlerësuar ofertat e pranuar dhe për paditësit kanë konstatuar se nuk ka dorëzuar deklaratën nën betim, andaj janë trajtuar si të papërgjegjshëm.

Nga Raporti i vlerësimit të tenderëve i datës 23.05.2014, gjykata ka konstatuar se komisioni për vlerësimin e ofertave pas shqyrtimit të ofertave të pjesëmarrësve ka konstatuar se oferta e paditësve ka qenë e përgjegjshme me kërkesat administrative dhe financiare, teknike dhe profesionale, por nuk ka qenë e përgjegjshme me kërkesat e pranueshmërisë dhe përshatshmërisë profesionale, andaj i njëjti është trajtuar si ofertues i pa përgjegjshëm.

Gjykata vlerëson se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri nuk ka vepruar drejtë kur ka refuzuar ankesën e paditësit ndaj Vendimit nr. 30618 të datës 02.09.2014 të Kuvendit të Komunës së Kamenicës për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga komisioni i vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatshkurtër, për shkak se paditësit përmes provave të dorëzuara kanë dëshmuar se kanë qenë të përgjegjshëm ndërsa i padituri nuk ka vepruar sipas vendimit të gjykatës për sjelljen e kopjes së pa hapur të ofertës së paditësve për të konstatuar dokumentet që janë dorëzuar së bashku me ofertë nga paditësit.

Me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike, gjykata me procesverbalin e datës 06.07.2023 e ka obliguar të paditurin që të dorëzoj zarfin e dytë – kopje të ofertës së paditësve apo nëse i njëjti është hapur, përbërjen e komisionit dhe procesverbalin e hapjes së zarfit, mirëpo, pavarësisht detyrimit, e paditura as me përgjigje në padi e as në seancën e shqyrtimit kryesor, të obliguar sipas procesverbalit të datës 06.07.2023, nuk ka ofruar zarfin e dytë – kopje të ofertës së paditësve apo eventualisht procesverbalin e hapjes së të njëjtit.

Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se i padituri nuk e ka provuar me asnjë provë të vetme pretendimin se me rastin e rishqyrtimit dhe rivendosjes komisioni për shqyrtimin e ankesave ka vendosur që të refuzojë ankesën e paditësve për shkak se është shikuar kopja dhe origjinali i ofertës dhe është vërejtur se me rastin e ofertimit ka munguar deklarata nën betim e OE Agrounion Sh.p.k.

Neni 37 i LKA-së përcakton se: *“1. Nëse gjykata nuk e hedh poshtë padinë, sipas të paragrafit 2. të nenit 33, apo në bazë të nenit 34 të këtij ligji ose nuk e anulon aktin administrativ sipas nenit 35 të këtij ligji, gjykata do t’ia dërgojë nga një kopje të padisë dhe të dokumenteve të bashkëngjitura në përgjigje palës së paditur dhe personave të interesuar. 2. Përgjigjja jepet në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e dorëzimit të padisë në përgjigje palës. 3. Në afatin e*

caktuar pala ka për detyrë t'i dërgojë gjykatës të gjitha shkresat që kanë të bëjnë me lëndën. Nëse pala e paditur edhe pas kërkesës së dytë nuk i dërgon shkresat e lëndës, apo nëse deklaron se nuk mund t'i dërgojë, gjykata do të vendosë për çështjen edhe pa shkresat e lëndës.” Në këtë kuptim gjykata vlerëson se në procedurën e konfliktit administrativ organi administrativ i paditur ka për detyrim që gjykatës me përgjigje në padi ti dorëzoj të gjitha shkresat që kanë të bëjnë me lëndën por me përgjigjen në padi të dorëzuar me datë 15.04.2021 i padituri nuk ka dorëzuar të gjitha shkresat me të cilat mund të vërtetohen pretendimet lidhur me gjendjen faktike të kontestuar, ashtu që gjykata përsëri e ka obliguar të paditurin përmes aktvendimit në procesverbalin e seancës së datës 06.07.2023, duke e paralajmëruar të paditurit për pasojat në rast se nuk dorëzon shkresat të cilat gjenden tek i padituri dhe të cilat janë të nevojshme për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike të konstatuar nga i padituri në procedurë administrative.

Gjykata nga përmbajtja e vendimit kontestues, gjykata ka konstatuar se Kuvendi Komunal Kamenicë, me datë 31.01.2011 ka miratuar vendimin 01nr.08 për themelimin e vendgjuetisë në territorin e Kamenicës dhe ka obliguar Zyrën e Prokurimit që në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 06/2009 për Dhënien në Menaxhim të Vendgjuetive të përbashkëta dhe duke zbatuar procedurat e parapara me Ligjin për Prokurimin Publik të përzgjedhë subjektin për menaxhimin e vendgjuetisë.

Lidhur me këtë, gjykata konstaton se i padituri ka zhvilluar procedurën e dhënies me qera të vendgjuetisë në Kamenicë në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik. Në kuptim të kësaj, Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik (në fuqi nga data 01.02.2012), në pikën 29 par. 3 dhe 4 përcakton se: *“29.3 Tenderi do të dorëzohet te AK në një formë të origjinalit dhe një numër të kopjeve të cilat AK i ka kërkuar në mënyrë të qartë në dosjen e tenderit. Tenderi origjinal si dhe kopjet e kërkuara do të jenë identike. Njëra nga kopjet e dorëzuara do të mbahet e pa-hapur nga AK për Organin Shqyrtues të Prokurimit “OSHP” si dëmi në rast të dyshimit rreth përmbajtjes së tenderit. 29.4 Tenderuesi do të mbyllë tenderin origjinal dhe secilën kopje në zarfe të veçanta dhe në ballë të secilit zarf do të: shënojë qartë “Origjinal” ose “Kopje”; do të shënojë numrin e prokurimit siç është cekur në dosje të tenderit; dhe do të shënojë emrin dhe adresën e tenderuesit.”*

Gjykata po ashtu konstaton se neni 10 par. 8 i Ligjit për Prokurimin Publik përcakton se: *“ ... Autoriteti kontraktues gjithashtu do t'i sigurojë qasje dhe kopje të shënimeve dhe informatave një gjykate kompetente, nëse qasja ose kopjet e tilla kërkohen nga një urdhër i nxjerrë nga*

gjkata e tillë. Autoriteti kontraktues menjëherë do të sigurojë qasjen dhe kopjet e kërkuara në mënyrë të rregullt dhe pa pengesa.”

Në kuptim të dispozitave të lartcekura, gjykata konstaton se i padituri nuk i është përmbajtur obligimeve ligjore që gjykatës ti dorëzojë zarfin kopje të mbyllur apo procesverbalin e hapjes së këtij zarfi në mënyrë që të vërtetohet gjendja faktike e konstatuar nga i padituri në vendimin kontestues dhe atë se anëtari i konzorciumit nuk e ka dorëzuar deklaratën nën betim. Prandaj gjykata në kuptim të nenit 37 par.3 e vendosi këtë çështje në mungesë të shkresave të lëndës pasi që nga provat e administruara, nuk arriti të konstatoj si të vërtetuar drejtë gjendjen faktike në procedurë administrative, andaj vendosi që të anulojë Vendimin nr. 29495 të datës 19.09.2018 i nxjerrë nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave pranë Komunës së Kamenicës si dhe Vendimi nr. 30618 i datës 02.09.2014 i Kuvendit Komunal Kamenicë.

Gjykata vendosi që të anulojë si të kundërligjshëm Vendimin nr. 30618 i datës 02.09.2014 i nxjerrë nga Kuvendi Komunal Kamenicë dhe Vendimin nr. 29495 të datës 19.09.2018 të shkallës së dytë për refuzimin e ankesës, në kuptim të nenit 43 të LKA-së i cili përcakton se: *“1. Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative. 2. Nëse gjykata konstaton se konflikti administrativ nuk mund të shqyrtohet në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative për shkak se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara ekzistojnë kontradikta në akte, gjë që në pikat esenciale nuk janë vërtetuar plotësisht, e që nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, ose konstaton se në procedurën administrative nuk janë respektuar rregullat e procedurës, që do të kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes, gjykata do të anulojë me aktgjykim aktin e kontestuar administrativ. Në një rast të tillë, organi kompetent ka për detyrë të veprojë ashtu si është caktuar në aktgjykim dhe të nxjerrë akt të ri administrativ. 3. Nëse anulimi i aktit administrativ, sipas paragrafit 2. të këtij neni dhe zhvillimi i përsëritur i procedurës në organin administrativ kompetent do të shkaktonte për paditësin ndonjë dëm, i cili me vështirësi do të riparohej, apo nëse në bazë të dokumenteve zyrtare ose të provave të tjera në shkresat e lëndës është e qartë se gjendja faktike ndryshon nga ajo që është vërtetuar në procedurën administrative, apo nëse në të njëjtin konflikt administrativ është anuluar një herë akti administrativ, kurse organi administrativ kompetent nuk ka vepruar sipas aktgjykimit, gjykata mundet edhe vetë të vërtetojë gjendjen faktike ose me anë të organit tjetër dhe në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nxjerr aktgjykimin, respektivisht vendimin”.* Pasi që në këtë çështje me Aktgjykimin A.nr. 2090/2014 të datës 16.11.2017 i nxjerrë nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative është anuluar një herë akti

administrativ i shkallës së dytë, ndërsa i padituri me vendimin kontestues kishte vendosur përsëri njëjtë duke mos vepruar sipas aktgjykimit, gjykata me provat që kishte në dispozicion vërtetoi vetë gjendjen faktike dhe erdhi në përfundim se Vendimi nr. 29495 datës 19.09.2018 i nxjerrë nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave pranë Komunës së Kamenicës si dhe Vendimi nr. 30618 i datës 02.09.2014 i Kuvendit Komunal Kamenicë duhet të anulohen si të kundërligjshme dhe në kuptim të nenit 46 par.4 të LKA-së ky vendim të zëvendëson aktet e anuluar.

Lidhur me kërkesën për kompensimin e dëmit, gjykata veproi në kuptim të nenit 46 par. 5 të LKA-së i cili përcakton se: *“5. Me aktgjykim, me të cilin anulohet akti i kontestuar administrativ, gjykata do të vendosë edhe për kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit, nëse të dhënat e procedurës japin për këtë gjë bazë të sigurt. Në të kundërtën, gjykata do ta udhëzojë paditësin që kërkesën e vet ta realizojë në procedurën kontestimore”*, pasi që provat në këtë çështje nuk kanë dhënë bazë të sigurt për caktimin e dëmit, ashtu që gjykata, paditësit i udhëzoi që kërkesën për kompensimin e dëmit ta realizojnë në procedurë kontestimore.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 64 të Ligjit për konfliktet Administrative, i cili përcakton që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 43 par.3 dhe 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.96/22 datë 31.07.2023

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.